




TË DHËNAT PËR ASETIN
Shitja e Aseteve me Likuidim nr. 45
Njësia nr. 42
Ereniku PP Toka Rastavica D

Emri i NSh.-së	Ereniku Prodhimtaria Primare, Gjakovë ("Ndërmarrja")
Lloji i shitjes	Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	03 prill 2019 në sallën e konferencave "Hotel Grand" - Prishtinë
Depozita e Ofertës	Euro 25,000
Vendndodhja e Asetit	Rastavicë, Komuna Gjakovë
<u>Përshkrimi i Asetit</u>	Kjo shitje ofron parcelën kadastrale nr.790 me sipërfaqe prej 46053m² me kulturë arë e klasës 1, parcelën nr. 789 me sipërfaqe prej 8611m² me kulturë mal e klasës 3, parcelën nr. 791 me sipërfaqe prej 12214m² me kulture mal i klasës 3 dhe parcelën nr. 792 me sipërfaqe prej 3244m² me kulture kullosë e klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 70122m² (7ha, 01ari 22m²) që ndodhen në ZK Rastavicë, Komuna Deçan. Kompleksi i parcelave ka qasje në rrugë publike. Ekziston një kërkesë pronësore nga një subjekt fizik, refuzuar nga AL (12.08.2015), ku pala ka bërë ankesë në DHPGJS kundër vendimit të AL-së. Pala e njëjtë ka ngrit padi në Gjykatën Komunale në Pejë për vërtetim pronësie (13.09.2012), ende pa ndonjë vendim. Gjithashtu një padi është parashtruar në DHPGJS për aprovimin e masës së përkohshme dhe anulimin e vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së lidhur me tenderimin e asetit e cila është refuzuar si e pabazuar nga Kolegji i Gjykatës së Apelit me datë 24.05.2018 dhe ka vërtetuar aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-III-18/0025 të dt. 10.05.2018, konfirmuar me aktvendimin C-III-18/0025 dt. 19.12.2018.
Shfrytëzuesit	Nga vizita në teren shihet se toka ishte pjesërisht e punuar dhe rrethuar nga palë të panjohura dhe pa lejen e AL/AKP.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Foto/ortofoto ose
informata tjera për
asetin në shitje



Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org.